



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

**A.A.nr.10/2024**

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e gjyqtarëve: Nebojsha Boriçiq, kryetar i kolegjit, Nenad Laziq dhe Ragip Namani, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të të dënuarit A. S. nga P., me objekt - kërkesë për lirim me kusht, duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit parashtruar kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D nr.63/24 datë 20.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2024, nxjerr si vijon:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të dënuarit A. S., parashtruar kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D.Nr.63/24 të datës 20.02.2024.

**Arsyetimi**

Me aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht PLK.D.Nr.63/24 të datës 20.02.2024, në pikën I të dispozitivit, është refuzuar kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit A. S., nga babai ... dhe nëna ..., e gjinisë ..., i lindur më ... në P., i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që pas skadimit të afatit prej 3 muajsh, kërkesa për lirim me kusht mund të rishqyrtohet.

Kundër aktvendimit të lartpërmendur të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D.Nr.63/24, datë 20.02.2024, i dënuari A. S. në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj ankesën dhe të ndryshojë aktvendimin e kontestuar të Panelit për Lirim me Kusht, ashtu që do të aprovoj kërkesën e tij për lirim me kusht.

Gjykata Supreme e Kosovës, në pajtim me nenin 117, paragrafët 11 dhe 12 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr. 08/L-132, shqyrtoi ankesën e parashtruar, aktvendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR, nr. 183/2022 të datës 15.08. 2022, A. S. është shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, paragrafi 1 i KPRK, dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh, i cili aktgjykim vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR nr.488/2022 të datës 25.10.2022.

I dënuari ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht nëpërmjet Institucionit Korrektues ku vuan dënimin me burg. Kërkesa për lirim me kusht është dorëzuar më 05.02.2024, me të cilën është kërkuar lirimi me kusht, me pretendimin se edhe me pjesën e mbajtur të dënimit është arritur qëllimi i dënimit, dhe se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Në seancën e mbajtur më 20.02.2024, Paneli për lirim me kusht ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përcjellës të personave përgjegjës të Shërbimit Korrektues të Kosovës, deklaratën e pritjeve lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimimit me kusht, siç parashihet me Neni 116 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kështu që pas analizës dhe vlerësimit të të gjitha fakteve relevante, ka gjetur se kërkesa për lirim me kusht nuk është e bazuar, dhe ka refuzuar të njëjtën. Në arsyetimin e aktvendimit të Bordit për Lirim me Kusht, ndër të tjera thuhet se me rastin e vendosjes sipas kërkesës së të dënuarit, paneli ka vlerësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Rregullores nr.12/2023 për punën e Panelit për Lirim me Kusht, si dhe të gjitha kushtet e parapara në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ka ardhur në përfundim se akoma nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve penale të paraparë me nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale. Në rastin konkret, Paneli ka marrë parasysh nenin 11 të Rregullorës nr. 12/2023, pasi që pesha e veprës penale është tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë duke parandaluar përhapjen e krimeve të tilla dhe të ngjashme, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit refuzohet për një periudhë prej tre muajve, ashtu që e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati. Në një gjendje të tillë faktesh, për Gjykatën Supreme të

Kosovës i pranueshëm është qëndrimi i Panelit për Lirim me Kusht si i ligjshëm dhe i rregullte, si dhe arsyetimi që ka dhënë paneli, duke aprovuar të gjithë faktorët me ndikim për vendosje në këtë çështje konkrete juridike, dhe me zbatimin e drejtë të dispozitave përkatëse të Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe kritereve të përcaktuara me Rregulloren Nr. 12/2023.

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me vlerësimin e Panelit se nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha kriteret për lirim me kusht e të dënuarit dhe se risocializimi ende nuk është i plotë, siç kërkohet me ligj. Paneli me të drejtë ka lënë mundësinë e riparashtrimit të të kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht pas tre muajsh, dhe se me rastin e shqyrtimit të se njëjtës nuk do të jetë me ndikim vendimi paraprak me të cilin kërkesa për lirim me kusht është refuzuar.

Bazuar në të gjitha që u parashtruan më sipër, Gjykata Supreme ka gjetur se pretendimet në ankesën e të dënuarit janë të pabazuara, ngase nuk janë me ndikim për vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar Paneli për Lirim me Kusht. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i kontestuar i Panelit është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se ligji material është zbatuar drejt dhe se ligji nuk është cenuar në dëm të të dënuarit.

Bazuar në këtë që u tha më sipër, duke zbatuar nenin 117, paragrafët 11 dhe 12 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale nr. 08/L-132, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

**A.A.nr.10/2024, data 18.03.2024.**

**Kryetar i kolegjit,  
Nebojsa Boriçiq**

Përktheu: Drita Kelmendi